



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

DATË/A:	21.01.2025
REFERENC-Ë:	22/6168/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Daakonn" Shpk, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr. prot.: 22/6168/621/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Daakonn" Shpk, Prishtinë, për veprimtarinë: "Grumbullimi, Ndarja, Transporti dhe Magazinimi i Përkohshëm i Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit" në Varosh, Komuna e Ferizajt.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*  
*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary*

---

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 5 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, nenit 14 paragrafi 5 dhe nenit 18 të Ligjit Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

## V E N D I M

Kompania "Daakonn" Sh.p.k. Prishtinë, pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: "Grumbullimi, Ndarja, Transporti dhe Magazinimi i Përkohshëm i Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit", në ngastrën kadastrale Nr. P-72217011-00318-0, në Z.K. në Varosh, Komuna e Ferizajt, nën kushtet si vijon:

- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Kreu II Neni 17;



- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji Nr. 04/L-60 për Mbeturina me theks të veçantë Kapitulli VII - Aktivitetet për Administrimin e Mbeturinave dhe Neni 40 si dhe Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-60 për Mbeturina;
- Në rast të trajtimit të mbeturinave të rrezikshme të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 03/2021 për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme
- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji për Ujëra;
- Të zbatohen obligimet dhe përgjegjësitë të cilat dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
- Mbeturinat të klasifikohen dhe të vendosen në kontejner të veçantë;
- Kontejnerët të vendosen në hapësirë të mbuluar;
- Gjatë transportit të mbeturinave me kamionë me qëllim të evitimit të derdhjes së mbeturinave në rrugë, mbeturinat të cilat transportohen duhet të jenë të mbuluara;
- Të pastrohet platoja e qendrës vazhdimisht;
- Të spërkaten me ujë vazhdimisht mbeturinat ndërtimore gjat procesit të trajtimit;
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet dhe kontejnerët për trajtimin dhe magazinim e përkohshëm të mbeturinave të materialit ndërtimor, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;
- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave sanitare dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operationale (të ndërtohen sedimentuesit dhe seperatori për ndarjen e mbeturinave të lëngëta), para shkarkimit të tyre;
- Të vendosen pajimet adekuate për trajtim dhe magazinim të përkohshëm të mbeturinave të ngurta dhe lëngta;
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr. 04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.



- Ndalohet veprimtaria e Kompanisë “Daakonn” shpk, nga Prishtina, të i Lëshohet Pëlqimi Mjedisor për “Grumbullimin, Ndarjen, Transportit dhe Magazinimin e Përkohshëm të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit” në Z.K. Varosh, komuna e Ferizajt, në ngastrën kadastrale Nr. P-72217011-00318-0, në largësi jo më pak se tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
  - Në raste kur në mbeturinat e krijuara gjatë ndërtimi dhe/apo rrënimi haset në mbeturina të rrezikshme, si mbeturina të azbestit apo ndonjë mbeturinë tjetër e rrezikshme, Kompania detyrohet që gjat trajtimit të këtyre mbeturinave ta njoftoj Inspektoratin e MMPHI-së.

Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura duhet t’i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, Pëlqimi do të revokohet (anulohet).

Pëlqimi Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionit përcjellës të dorëzuar për kompaninë “Daakonn” Shpk, Prishtinë, për veprimtarinë: “Grumbullimin, Ndarjen, Transportit dhe Magazinimin e Përkohshëm të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënimit”, në ngastrën kadastrale Nr. P-72217011-00318-0, në Z.K. në Varosh, Komuna e Ferizajt, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.



**Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM Nr. 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 22/61868/ZSP/ /25 datë: 21.01.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunës së Ferizajt
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPHI



U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

